



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 202300230/6

Tiranë ___/___/2023

Lënda : *Rekomandim për analizimin e rastit të shkeljes së kryer nga punonjësit e policisë rrugore në rastin e konstatimit dhe gjyqimit të kundërvajtjes administrative të kryer nga shtetasi L.M..*

DREJTORISË VENDORE TË POLICISË
Korçë

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT
Tiranë

Me shkresën nr. K2/L3-2 prot., datë 02.03.2023, drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë, ju vumë në dijeni se në institucionin e Avokatit të Popullit në datën 28.02.2023 ka paraqitur një ankesë shtetasi L.M.. Ankuesi shkruan se në datën 08.10.2022 është ndaluar nga punonjësit e policisë rrugore në qytetin e Pogradecit, të cilët pasi i kontrolluan dokumentacionin e mjetit, kanë konstatuar se leja e drejtimit të tij ishte e parregullt sepse i kishte mbaruar afati i vlefshmërisë. Pas këtij konstatimi ai është arrestuar, ndërsa automjeti i është konfiskuar dhe ndërkohë është gjobitur me 35.000 lekë, shumë të cilën e ka paguar.

Ankuesi pretendon se nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec me shkresën nr. 6584 Prot./N.H., datë 10.10.2022, është lëshuar një urdhër dërguar Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë për kthimin e sendeve të sekuestruara atij në kuadër të procedimit penal nr. 322/2022, por ky urdhër nuk zbatohet nga policia.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e këtij rasti, i kërkua Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë që të na dërgonte një informacion lidhur me këtë ankesë dhe konkretisht cilat janë

shkaqet ligjore për mos zbatimin e urdhrit të prokurorit për kthimin e sendit (motorçikletës) ankuesit L.M..

Drejtoria Vendore e Policisë Korçë me shkresën nr. 1773/1 prot., datë 17.03.2023 na ktheu përgjigje, nëpërmjet të cilës na informoi lidhur me shkeljen e Kodit Rrugor të kryer nga ankuesi L.M. në datën 26.10.2022. Gjithashtu në këtë përgjigje u informuam se shtetasi L.M. ka bërë ankim në Organin Administrativ Shtetëror (OASH), i cili me vendimin nr. 989, datë 25.11.2022 ka vendosur lënien në fuqi të masës administrative të vendosur nga agjenti verifikues.

Së bashku me përgjigjen ky organ na dërgoi edhe fotokopje të disa dokumenteve, si “Procesverbalin e konstatimit të shkeljes” me nr. serie 1452843, datë 26.10.2022, i mbajtur nga agjenti verifikues Leorjan Groballi ndaj shtetasit L.M., drejtues i mjetit motorçikletë, marka “JAMAHA”, me targë PG 012 A; “Raportin e shërbimit” të mbajtur në datën 26.10.2022 nga agjenti verifikues Leorjan Groballi; Vendimin nr. 989, datë 25.11.2022 të OASH, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë; “Proceverbali i dorëzimit të automjetit” motorçikletë me targë PG 012 A në pronësi të shtetasit L.M., në pikën e ruajtjes, mbajtur në datën 08.10.2022; Lejen e qarkullimit të automjetit motorçikletë e markës “JAMAHA” me targë LB 012; Shkresën e Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Korçë nr. 10473/1 prot., datë 16.11.2022, drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë.

Nga përgjigjja e cituar më sipër konstatoam se na u dërgua informacion lidhur me shkeljen ligjore të kryer nga shtetasi L.M. në datën 26.10.2022, *ndërkohë që ankuesi shkruan se shkelja e kryer prej tij ka ndodhur në datën 08.10.2022. Për këtë rast ai na ka dërguar edhe kopje të procesverbalit të arrestimit në flagrancë të tij dhe të kontrollit personal të datës 08.10.2022.* Gjithashtu u informuam edhe për masën administrative të vendosur ndaj shtetasit L.M. për të cilën ai nuk ka paraqitur ndonjë pretendim në ankesën e bërë në institucionin tonë.

Ndërsa për shqetësimin për të cilin na është drejtuar ankuesi, *mos zbatimin e urdhrit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, dërguar Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë me shkresën nr. 6584 Prot./N.H., datë 10.10.2022, për kthimin e sendit të sekuestruar atij në kuadër të procedimit penal nr. 322/2022,* nuk u informuam.

Për këtë arsye me shkresën nr. K2/L3-4 prot., datë 28.03.2023, i kërkuam Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë të na dërgonte një informacion shtesë lidhur me shkaqet ligjore të mos zbatimit të urdhrit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec të cituar më lart, për kthim sendi të sekuestruar shtetasit L.M. në kuadër të procedimit penal nr. 322/2022.

Në vijim të kërkesës tonë, Drejtoria Vendore e Policisë Korçë me shkresën nr. 2476/1 prot., datë 07.04.2023, na informoi se në datën 08.10.2022, në qytetin e Pogradecit shtetasi L.M. është konstatuar nga shërbimi i policisë rrugore në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë në drejtim të mjetit tip motomjet, marka “JAMAHA”, me targë PG 012

A në shkelje të nenit 178, pikat 1 deri 7 të Kodit Rrugor. Për këtë rast është plotësuar Procesverbali i konstatimit të shkeljes nr. 1450118, datë 08.10.2022. Njëkohësisht çështja është referuar në organin e prokurorisë për shkelje të nenit 291 të Kodit Penal. Pasi materialet janë kthyer nga organi i prokurorisë, në bazë të nenit 216/3 të Kodit Rrugor, agjenti verifikues ka plotësuar Procesverbalin e Konstatimit të Shkeljes nr. 1452843 për shkeljen e neneve nr. 92, 79, 124, 191, 203 të Kodit Rrugor.

Gjithashtu në këtë shkresë u informuam se në nenin 92/6 të Kodit Rrugor, përveç masës administrative me gjobë, parashikohet edhe masa plotësuese e konfiskimit të mjetit. Mbi bazën e këtij procesverbali dhe pas ankesës së bërë nga shtetasi L.M., OASH ka marrë vendimin nr. 989, datë 25.11.2022 ku është lënë në fuqi masa e vendosur nga agjenti verifikues, gjoba dhe konfiksimi i motomjetit. Ndërkohë u informuam se procedura e ndjekur në këtë rast është bazuar në nenin 217 të Kodit Rrugor.

Bashkëlidhur me përgjigjen na u dërguan edhe kopja e “Procesverbalit të konstatimit të shkeljes” nr. 1450118, datë 08.10.2022.

Nga informacioni shtesë i dërguar nga Drejtoria Vendore e Policisë Korçë me shkresën e fundit të cituar më sipër, rezulton se konfiksimi i motomjetit të ankuesit L.M. është bërë në kuadër të kundërvajtjes administrative të kryer nga ana e tij në datën 08.10.2022 sepse ka qarkulluar me një mjet për të cilin nuk është lëshuar leje qarkullimi sikurse parashikohet në pikën 6 të nenit 92 të Kodit Rrugor. Pra, pavarësisht faktit që në përgjigjet e dërguara ky organ nuk shprehet drejtpërdrejtë për arsyet e mos zbatimit të urdhrit të organit të prokurorisë për kthimin e sendit (motorit), kuptohet qartë se motomjeti në fjalë nuk i është sekuestruar ankuesit për efekt të procedimit penal të filluar ndaj tij, por i është konfiskuar në kuadër të procedimit administrativ dhe sipas dispozitave të Kodit Rrugor.

Ndërkohë konstatojmë se ndaj drejtuesit të motomjetit, shtetasit L.M., nga punonjësit e policisë efektivë të Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë, janë mbajtur/përpiluar dy “Procesverbale të konstatimit të shkeljes” respektivisht:

1. Procesverbali me nr. 1450118, datë 08.10.2022, ora 10:00, i mbajtur nga punonjësit e policisë Leorjan Groballi dhe Dëfrim Malo, në rrugën Petrushë - Qafë Thanë, vendi Markata Pogradec, sepse është konstatuar që qarkullon me motomjetin, tip “JAMAHA”, me targë PG 012 A, në shkelje të nenit 178/1/7, pa pasur dokumentacion me vete, pa leje qarkullimi. Për këtë shkelje ai është gjobitur me njëmijë lekë dhe ndërkohë i është vendosur edhe masa plotësuese e “Ndalimit administrativ të mjetit”.

Nga ky procesverbal rezulton se ai është përpiluar në mungesë të shkelësit. Ndërsa në anë të dokumentit ka shënimin se shkelësi ka të drejtën e ankimit në OASH.

Sqarojmë se si nga deklaratimet e ankuesit ashtu edhe nga përgjigjet e dërguara nga Drejtoria Vendore e Policisë Korçë evidentohet se drejtuesi i motomjetit nuk ka qenë në mungesë, sikurse rezulton nga ky procesverbal, por ka qenë prezent. Theksojmë se, nëse

ai në këtë rast nuk do të ishte prezent, do të kishte qenë e pa mundur që punonjësit e policisë të kishin konstatuar mangësitë e dokumentacionit të përshkruar në procesverbalin e cituar më sipër. Ndërkohë prezencën e drejtuesit të motomjetit L.M. e provon në mënyrë të qartë edhe fakti tjetër që ai po në datën 08.10.2022, ora 13:00, është arrestuar në kushtet e flagrancës për shkelje të dispozitave të Kodit Rrugor. Sipas “Procesverbalit për arrestimin në flagrancë” të tij rezulton se: *“Në datën 08.10.2022, rreth orës 10:00, në qytetin e Pogradecit, shtetasi L.M. është konstatuar duke drejtuar mjetin motor të markës “JAMAHA” me targë PG 012 A, i pa pajisur me leje drejtimi”.*

2. Procesverbali i konstatimit të shkeljes me nr. serie 1452843, datë 26.10.2022, ora 14:00, vendi Komisariati i Policisë Korçë, i mbajtur nga agjenti verifikues Leorjan Groballi ndaj shtetasit L.M., drejtues i mjetit motorçikletë, tip “JAMAHA”, me targë PG 012 A; te rubrika e shkeljes, përshkruhet: *ka shkelur ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, nenet 92/1/6, 191/1, 79/3/10, 124/11, 203/1, 196/1, drejtuesi i motomjetit qarkullon me leje drejtimi të cilës i ka kaluar afati i vlefshmërisë, pa leje qarkullimi, pa siguracion, pa kontroll teknik.”*

Për këtë shkelje ai është gjobitur me 35000 (tridhjetë e pesëmijë) lekë dhe ndërkohë i janë vendosur edhe masat plotësuese e “Tërheqjes së lejes së drejtimit” dhe e “Konfiskimit të mjetit”.

Nga procesverbali rezulton se ky dokument është përpiluar në prezencë të shkelësit, i cili e ka nënshkruar atë dhe është shprehur se është dakord. Ndërsa anash ka shënimin se shkelësi ka të drejtën e ankimit në OASH.

Nga përmbajtja e këtyre procesverbaleve krijohet përceptimi se kemi të bëjmë me dy raste të ndryshme të shkeljes së Kodit Rrugor të kryera nga shtetasi L.M. gjatë drejtimit të të njëjtit motomjet, njërën e ka kryer në datën 08.10.2022, ndërsa tjetrën e ka kryer në datën 28.10.2022, njëra shkelje e kryer në Pogradec dhe tjetra e kryer në Korçë. Në të dyja rastet janë konstatuar mungesë të dokumentacionit të nevojshëm ligjor për të qarkulluar në rrugë.

Mirëpo fakti që ankuesi përshkruante në ankesë vetëm një rast shkeljeje, atë të datës 08.10.2022, si dhe fakti tjetër që atij i ishte bllokuar motomjeti nga punonjësit e policisë, send i cili ishte dorëzuar që në datën 08.10.2022 pranë pikës së ruajtjes në Komisarlatin e Policisë Pogradec, na krijoi dyshimin e arsyeshëm se një nga shkeljet e referuara në dy procesverbalet e ndryshme nuk qëndronte.

Nga informacioni verbal i marrë nga kryetari i OASH pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë u informuam se bëhet fjalë për një rast të vetëm shkeljeje të dispozitave të Kodit Rrugor të kryer nga drejtuesi i motomjetit L.M., ai i kryer në datën 08.10.2022, i konstatuar në qytetin e Pogradecit. Sipas tij, punonjësit e policisë Leorjan Groballi dhe Dëfrim Malo të cilët kanë konstatuar shkeljen, i kanë lënë 5 ditë afat drejtuesit të motomjetit për të sjellë dokumentacionin e munguar, njëra prej të cilave ishte edhe leja e

qarkullimit. Meqënëse ai nuk i ka sjellë ato, punonjësi i policisë Leorjan Groballi ka përpiluar procesverbalin e dytë, atë të datës 26.10.2022.

Ne konstatojmë se ky veprim nuk është korrekt dhe në përputhje me aktet normative në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet juridike në fushën e qarkullimit rrugor dhe respektivisht Kodin Rrugor, Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 155, datë 05.08.2022 “Për procedurat e evidentimit dhe të shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative dhe pasqyrat statistikore në fushën e qarkullimit rrugor” dhe Procedurën standarde “Për veprimet që kryhen nga strukturat e Policisë së Shtetit me mjetet motorike që ndalohen administrativisht/sekuestrohen apo konfiskohen”, miratuar me urdhrin nr. 1299, datë 03.11.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në këto akte është parashikuar edhe dhënia e masës administrative plotësuese ndaj drejtuesve të automjeteve që shkelin dispozitat e Kodit Rrugor, por në asnjërin prej tyre nuk parashikohet mbajtja/përpilimi i dy procesverbaleve të konstatimit të një rasti shkeljeje.

Në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 155, datë 05.08.2022, Kreu VI, pika 5, parashikohet se: *“Në të gjitha rastet kur Kodi Rrugor parashikon përveç sanksionit me gjobë, edhe masa administrative plotësuese, kompetenca e vendosjes së masës administrative plotësuese është e agjentit verifikues që ka verifikuar shkeljen”.*

Ndërsa në pikën 14 të këtij Kreu parashikohet se: *Në çdo rast, kur agjenti verifikues merr masë administrative plotësuese, për mjetin apo dokumentet e drejtuesit të mjetit, plotësohet raporti i shërbimit sipas modelit lidhja nr. 7 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi. Ky raport administrohet si pjesë e procesverbalit të konstatimit shkeljes.*

Në rastin e shtetasit L.M. nga njëri prej punonjësve të policisë konkretisht Leorjan Groballi në datën 26.10.2022 është mbajtur raporti i shërbimit, por ai nuk është bërë në përputhje me dispozitën e cituar më sipër, për arsyet si vijon:

a) Meqënëse në datën 08.10.2022 nga punonjësit e policisë Leorjan Groballi dhe Dëfrim Malo është marrë edhe masa plotësuese e “Ndalimit administrativ të mjetit”, atëherë raporti i shërbimit duhet të ishte mbajtur në të njëjtën datë, më 08.10.2022 dhe jo më vonë sikurse është bërë në fakt.

b) Nga përmbajtja e këtij raporti rezulton se ai është i pasaktë sepse të le të kuptosh se shkelja e kryer nga drejtuesi i motomjetit L.M. është bërë në datën 26.10.2022 dhe jo kur ka ndodhur në fakt, në datën 08.10.2022.

c) Përveç sa më sipër, raporti i shërbimit duhet të ishte përpiluar dhe nënshkruar nga të dy punonjësit e policisë që kanë bërë konstatimin e shkeljes në datën 08.10.2022 dhe jo vetëm nga njëri prej tyre, sikurse është bërë në fakt.

Ndërsa masa plotësuese e konfiskimit administrativ parashikohet në pikën 7/b të këtij Kreu. Sipas kësaj pike, kjo masë duhet të vendoset, kur kanë kaluar 5 ditë nga rrëzimi i ankesës nga OASH-ja, ose nga përfundimi i afatit për ankesë tek OASH-ja (pra nuk është paraqitur), ose nga përfundimi i periudhës së caktuar të sekuestrimit, kur nuk është paraqitur kërkesa për heqjen e sekuestrimit. Në fakt në rastin e ankuesit, masa plotësuese e konfiskimit administrativ të motomjetit është vendosur në datën 26.10.2022, para se ai të bënte ankimin në OASH, organ i cili është shprehur me vendimin e datës 25.11.2022. Pra, kjo masë është marrë në kundërshtim me Udhëzimin e cituar më sipër.

Ky veprim vjen në kundërshtim të plotë edhe me Procedurën standarde “Për veprimet që kryhen nga strukturat e Policisë së Shtetit me mjetet motorike që ndalohen administrativisht/sekuestrohen apo konfiskohen”, miratuar me urdhrin nr. 1299, datë 03.11.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, respektivisht me Kreun e III ku parashikohet përkufizimi i “Konfiskimit”. Sipas këtij akti nënligjor, konfiskimi është masë administrative plotësuese, e cila zbatohet pas mbarimit të fazës së ankimit ndaj aktit administrativ që vendos masën e dënimit për kundërvajtjen administrative dhe që ka të bëjë me kalimin e mjeteve në favor të Shtetit (pasi është ezauruar faza e sekuestros administrative).

Ndërkohë ai vjen në kundërshtim edhe me Kreun IV, Gërmat B/1/b të kësaj procedure ku parashikohet se: “Në rastet kur Kodi Rrugor parashikon masën plotësuese të sekuestrimit dhe konfiskimit administrativ, agjenti verifikues që konstaton dhe verifikon shkeljen, bën sekuestrimin e mjetit, duke e shënuar këtë në procesverbalin e konstatimit të shkeljes.

a)

b) *Plotësuese të konfiskimit administrativ, kur kanë kaluar 5 ditë nga rrëzimi i ankesës nga OASH, ose nga skadimi i afatit për ankesë tek OASH (pra nuk është paraqitur), ose nga skadimi i periudhës së caktuar të sekuestrimit, kur nuk është paraqitur kërkesa për heqjen e sekuestrimit, OASH shprehet me vendim për vlefshmërinë e konfiskimit të mjetit dhe kalimin e tij në Rezervat Materiale të Shtetit....”*

Gjithashtu në këtë rast konstatoam edhe disa mangësi në veprimtarinë e OASH-it pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës së shtetasit L.M.. Nga ky organ nuk janë evidentuar mangësitë e konstatuara nga ana jonë në dokumentacionin e përpiluar nga agjentët verifikues.

Po ashtu, në këtë rast, OASH nuk është shprehur me vendim për vlefshmërinë e konfiskimit të mjetit sikurse parashikohet në pikën 7 të Kreut VI të Udhëzimit të Ministrisë të Brendshme dhe në Kreun IV, gërmën B/1/b të Procedurës standarde të cituar më lart.

Sqarojmë se detyrimi i OASH për të marrë një vendim të tillë, parashikohet në dy akte respektivisht në Kreun VI/B/4/d të Udhëzimit dhe në Kreun IV//B/4/d të Procedurës

standarde me titull “*Dosja e mjetit që do të kalojë në Rezervat Materiale të Shtetit, përmban:*”

Në rastin e shtetasit L.M., OASH është mjaftuar vetëm me shqyrtimin e ankesës së tij ndaj masës administrative me gjobë dhe masës plotësuese të konfiskimit të marrë nga agjentët verifikues. OASH me vendimin nr. 989, datë 25.11.2022 ka vendosur lënien në fuqi të masës së gjobës në shumën 35000 lekë dhe kalimin e mjetit në SRMSH.

Në përfundim të shqyrtimit të këtij rasti, konstatojmë se veprimet dhe mosveprimet e punonjësve të policisë rrugore të lartpërmendur, si të atyre që kanë konstatuar shkeljen administrative dhe e anëtarëve të OASH cenojnë imazhin dhe reputacionin e Policisë së Shtetit dhe për pasojë trondisin besimin publik të këtij institucioni të administratës publike. Qytetari duhet të jetë i qartë në lidhje me aktet administrative dhe pasojat e tyre. Sjellim në vëmendje se rritja e besimit në publik të Policisë së Shtetit është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me rritjen e performancës së këtij organi në kryerjen e misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, atë të ruajtjes së rendit e të sigurisë publike, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, si nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, vlerëson se, bazuar në evidentimin e problematikës të lartpërmendur, si dhe për të garantuar një sjellje profesionale e të përgjegjshme të punonjësve të policisë, domosdoshmërisht lind nevoja e një reagimi nga strukturat drejtuese vendore e qendrore të Policisë së Shtetit, për të garantuar kryerjen me profesionalizëm, objektivitet dhe korrektësi të detyrave ligjore të këtij organi dhe respektimin e mbrojtjen e të drejtave të shtetasve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut, nga administrata publike”, në nenin 21/c të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku parashikohet se: “Pas përfundimit të hetimeve Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen”, dhe në nenin 21/d të këtij ligjit ku parashikohet se: “për shkelje të rënda, të vëna re, i propozon çdo organi, si dhe Kuvendit, shkarkimin e funksionarëve që janë kompetencë e tyre;”,

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të nevojshme për analizimin e këtij rasti dhe të shkeljeve të kryera nga punonjësit e policisë rrugore Leorjan Groballi dhe Dëfrim Malo, si dhe e anëtarëve të OASH, efektivë të Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë, nxjerrjen e përgjegjësive për mos zbatimin e detyrimeve ligjore të parashikuara në Kodin Rrugor, Udhëzimin e Ministrisë të Brendshme nr. 155, datë 05.08.2022 “Për procedurat e evidentimit dhe të

shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative dhe pasqyrat statistikore në fushën e qarkullimit rrugor” dhe Procedurën standarde “Për veprimet që kryhen nga strukturat e Policisë së Shtetit me mjetet motorike që ndalohen administrativisht/sekuestrohen apo konfiskohen”, miratuar me urdhrin nr. 1299, datë 03.11.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Marrjen e masave organizative nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për trajnimin në vijimësi të punonjësve të policisë rrugore lidhur me plotësimin me profesionalizëm, objektivitet dhe korrektësi të dokumentacionit që përpilohet në rastet e shkeljeve administrative të kryera nga drejtuesit e automjeteve në përputhje me aktet normative në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e policisë rrugore.

3. Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat eprore të Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për ushtrimin e kontroleve periodike për të vlerësuar saktësinë dhe vlefshmërinë e dokumentacionit të hartuar/përpiluar nga punonjësit e policisë rrugore në rastet e konstatimit të shkeljeve administrative të kryera nga drejtuesit e automjeteve.

4. Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për përgjithësimin e këtij rasti dhe të shkeljeve të konstatuara nga institucioni i Avokatit të Popullit në të gjitha strukturat vendore të Policisë së Shtetit, me qëllim mos përsëritjen e tyre në të ardhmen nga punonjësit e policisë.

5. Marrjen e masave organizative nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për kryerjen herë pas here të fushatave mediatike për ndërgjegjësimin e drejtuesve të mjeteve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të parashikuara në dipozitat e Kodit Rrugor dhe për pasojat që sjellin shkeljet e tyre.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi